



23/07/2025

02/219



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 13.06.2025 dhe filloi në ora: 10:05.

**Në mbledhje morë pjesë:** Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, antarët e komisionit: Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Rukije Bytyqi, dhe zyra për informim.

**Mungon:** Arlindë Rudi (PDK), Hamit Lima (LDK) dhe Sadik Vrenezi (PDK).

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -I- (parë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime, të katër anëtarëve, Kryesuesi konstataoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/691 datë:11.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit “Qytetar Nderi” i Komunës së Malishevës, për vitin 2025, humanistit z.Halil Kastrati.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë nr.01/711 datë:12.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ, për ndarjen e mirënjojheve.
3. Të ndryshme.

**Pika e parë**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/691 datë:11.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit “Qytetar Nderi” i Komunës së Malishevës, për vitin 2025, humanistit z.Halil Kastrati.

**Kryesuesi Argjend Thaçi:** Me këtë kërkesë kam knaqesinë dhe nderin të propozoj dhe nominimin e humanistit shqiptar .Halil Kastrati për titullin “Qytetar Nderi” të Komunës së Malishevës për vitin 2025, si një vlerësim i merituar për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në

përmirësimin e kushteve ekonomike e sociale për familjet në nevojë në të gjitha trojet shqiptare, në veqanti në Komunën e Malishevës. Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Unë e respektoj figurën e Halil Kastratit si qytetar i Komunës së Malishevës, por dhe si qytetar i Republikës së Kosovës. Jam pak kritik, por jo kundërshtues. Jam kritik ndaj kryetarit sepse po bëhen disa kapërcime jo të natyrshme. Për herë të parë në Komunën e Malishevës çmimi iu është dhënë vëllaut të Ismet Jashari Kumanova, që ka qenë në rregull dhe respekt për figurën e tij. Pastaj çmimet janë dhënë për tri figura për shtetasit amerikan që ka qenë në fryshtë e njejt. Unë mendoj që ka shumë figura të tjera që do duhet përfillim me i nderuar, me kaluar vite duke ndarë çmime për ta dhe pastaj me i ardhur radha figurës së Halil Kastrati dhe të tjerëve. Këto kapërcime nuk po më pëlqejnë, mirëpo ne jemi në rregull me këtë pjesë.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, Rukije!

**Rukije Bytyqi (anëtare e Nisma Socialdemokrate):** Për dallim nga Vetoni, unë Halil Kastratin e shoh si një prej figurave shumë të mëdha që ka dhenë një kontribut të madh, sidomos në qytetin e Suharekës ku është shtëpia për personat pa përkujdesje, por dhe në komunën e Malishevës ka kontribuar për ndërtimin e disa shtëpive. Meqenëse është një prej figurave, pse ne si Kosovë mos me favorizoj tonin se sa një që jep kontribut në një vend tjetër. Halili të gjithë kontributin e jep brenda Kosovës dhe e meriton ta ketë votën time.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, Gentianë!

**Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate):** Me një pikë që e tha Vetoni që kemi figura dhe brenda Malishevës, kjo është e vërtetë sepse kemi shumë figura që e meritojnë. Mirëpo ne dhe figurat e Malishevës nuk jemi duke i lënë anash sepse kemi çmime të shëndetësisë, arsimit dhe për trimëri dhe heroizëm.

Halil Kastrati ka dhënë kontribut të madh dhe në Malishevë, dhe mendoj që emri ti është shumë i qëlluar.

Çmimet paraprake që i kemi pasur shtetasit amerikan, duke u nisur nga Çlirimi që është bërë ne i kemi fal Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duhet dhe atyre të ju vjen rendi dhe t'i nderojmë.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, Veton:

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Unë nuk thash që është figurë e kontestueshme, në figurën e humanizmit, unë kam respekt për figurën e Halilit. Fjala qytetar nderi nënkupton që është qytetar përgjegjës i komunës tonë, që komuna jonë e nderon.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Kush është për rekomandim për Kuvend pikën e parë? Me vota unanimë të 4 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

### **Pika e dytë**

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë nr.01/711 datë: 12.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ, për ndarjen e mirënjohjeve

**Argjend Thaçi (Kryeues i Kuvendit):** Këshilli Organizativ i formuar me vendim të kuvendit të Malishevës, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit organizativ vndosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të Komunës të nominoj këto personalitetë për ndarjen e çmimeve të cekura si në vijim; Çmimi për Trimëri dhe Heroizëm: Naser Shala, Tahir Ulluri, Feim Thaçi, Hajdin Berisha, Hadrulla Mazreku. Për çmimin Hajdin Berisha për kontributin e dhënë në arsim propozojmë Sylejm Telaku dhe Haxhi Kastrati. Për çmimin Shpëtim Robaj për kontributin e dhënë në shëndetësi propozojmë Dr. Haki Balaj, Fatime Mazreku, Shehide Hoti-Gashi.

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Numri i çmimeve qenka rritur, a është propozim i këshillit.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Me propozim unanim të Këshillit është marrur vendim.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Kush është për rekomandim për Kuvend për pikën e dytë?

Me vota unanime të 4 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend. Faleminderit për prezencën! Këtë mbledhje e shpalli të myllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 10:20.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

